



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V

Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës
Mbledhja nr. 16

Prishtinë, më 27.5.2015, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR PUNË TË BRENDSHME, SIGURI DHE
MBIKËQYRJE TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS**

Në mbledhje morën pjesë: Daut Haradinaj- kryetar i Komisionit, Bojan Mitiq-nënkryetar i dytë, Ganimete Musliu, Qerim Bajrami, Rexhep Selimi, Nuredin Ibishi -anëtarë.

Mungoi: Fadil Demaku, Anton Quni dhe Zafir Berisha.

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Nur Çeku dhe Zarife Aliu.

Pjesëmarrës të tjerë: Sanije Berisha-OSBE; Lumnije Murati-Zyra e Presidencës së Kosovës; Përparim Kryeziu-QKSS dhe Arbanë Pireva, praktikante.

Mbledhjen e kryesoi, Daut Haradinaj, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Komisionit, të mbajtura më 17.4.2015, 22.4.2015 dhe 5.5.2015;
3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-22 për armë;
4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-17 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-246 për pajisje me armë, municion dhe pajisje përkatëse të sigurisë për institucionet e autorizuara shtetërore për siguri;
5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-15 për letërnjoftim;

6. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Komisionit, të mbajtura më 17.4.2015, 22.4.2015 dhe 5.5.2015

Procesverbalet u miratuan pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-22 për armë.

Kryetari i Komisionit, theksoi se pasi është miratuar në lexim të parë, Projektligji për Armë, ne jemi ngarkuar si Komision për ta shqyrtuar. Sipas procedurave të punës, vazhdojmë me krijimin e grupit punues për shqyrtimin e këtij projektligji. Propozoi që kryesues i grupit punues për Projektligjin për armë të jetë Rexhep Selimi.

Rexhep Selimi, theksoi se në legjislaturën e kaluar ky projektligj ka kaluar pjesën më të madhe të procedurave, por pasi legjislatura përfundoi më herët, tani është proceduar për shqyrtim. Prandaj, inkurajoj që anëtarët të cilët kanë qenë në legjislaturën e kaluar, të jenë pjesë e këtij grupi punues, si dhe të bashkohen edhe anëtarët e tjerë. Ndërsa, sa i përket Projektligjit nr. 05/L-17 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-246 për pajisje me armë, municion dhe pajisje përkatëse të sigurisë për institucionet e autorizuar shtetërore për siguri, pasi në legjislaturën e kaluar e ka kryesuar z.Anton Quni, propozoi që të jetë po i njëjti kryesues.

Kryetari i Komisionit, përveç kryesuesit, kërkoi që të deklarohet kush është *për*, që të jetë pjesë e grupit punues për Projektligjin për armë. Në të njëjtën kohë, shprehu gatishmërinë për të qenë edhe vetë pjesë e këtij grupi.

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, në këtë pikë të rendit të ditës, me vota unanime, mori këtë

VENDM

Formohet grupi punues për shqyrtimin e Projektligjit nr. 05/L-22 për armë, me këtë përbërje: Rexhep Selimi, kryesueses, Daut Haradinaj, Nuredin Ibishi, Ganimete Musliu dhe Bojan Mitiq, anëtarë.

4. Shqyrtimi i projektligjit nr. 05/L-17 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-246 për pajisje me armë, municion dhe pajisje përkatëse të sigurisë për institucionet e autorizuara shtetërore për siguri

Kryetari i Komisionit, për shqyrtimin e këtij projektligji kërkoi të propozohet kryesuesi dhe anëtarët e grupit punues.

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, në këtë pikë të rendit të ditës, me vota unanime, mori këtë

VENDIM

Formohet grupi punues për shqyrtimin e Projektligjit nr. 05/L-17 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-246 për pajisje me armë, municion dhe pajisje përkatëse të sigurisë për institucionet e autorizuara shtetërore për siguri, me këtë përbërje: Anton Quni, kryesues, Daut Haradinaj, Rexhep Selimi, Bojan Mitiq, Ganimete Musliu, Nuredin Ibishi-anëtarë.

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-15 për letërnjoftim

Kryetari i Komisionit, konsideroi se ky projektligj është i rëndësishëm për faktin se ka pasur ndryshime në vazhdimësi dhe më pas nevoja për digjitalizim. Gjithashtu, theksoi se do të ishte i nevojshëm edhe opinioni i shoqërisë civile. Nga z.Fadil Demaku është shprehur i gatshëm të kryesojë grupin punues për këtë projektligj, ndërsa anëtarë propozoi që të jenë të gjithë anëtarët e Komisionit.

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, në këtë pikë të rendit të ditës, me vota unanime, mori këtë

VENDIM

Formohet grupi punues për shqyrtimin e Projektligjit nr. 05/L-15 për letërnjoftim, me këtë përbërje: Fadil Demaku, kryesues, Qerim Bajrami, Daut Haradinaj, Bojan Mitiq, Rexhep Selimi, Nuredin Ibishi, Ganimete Musliu, Anton Quni, Zafir Berisha, anëtarë.

Qerim Bajrami, theksoi se për këtë projektligj do të ketë një amendament dhe për këtë do të kërkojë mbështetjen e Komisionit, ndërsa për çështjen që do të përfshihen në amendament, ka diskutuar edhe në Kuvend gjatë leximit të parë, sa i përket nenit 10 (dhjetë) të këtij projektligji. Pra, te shtypja e formularëve dhe letërnjoftimeve, thuhet: “formularët dhe letërnjoftimi shtypet në pajtim me ligjin për përdorimin e gjuhëve zyrtare në Kosovë”. Tutje theksoi se komuniteti boshnjak dhe turk e konsiderojnë si problem, pasi në letërnjoftim nuk është gjuha tyre. Konsideroi që kjo çështje është e thjeshtë dhe me vullnet të Komisionit, mund të përfshihet ky amendament. Neni që rregullon këtë çështje, nuk është i qartë. Gjithashtu, edhe Ligji për gjuhët zyrtare është pak i vjetër. Prandaj, konsideroi se me plotësimin e këtij projektligji, të shtohet fjalia: “dhe në gjuhën dhe alfabetin e parashtruesit të kërkesës”. Kjo do të thotë që personi nga

komuniteti boshnjak kur të parashtrojë kërkesën, ka të drejtë që në letërnjoftim të ketë edhe gjuhën boshnjake. Në praktikë, kjo çështje është që dy vite, dhe nëse nuk legalizohet kjo praktikë me ligj, kjo është në kundërshtim me ligjin. Agjencia që bën shtypjen e letërnjoftimit, e bën shtypjen në gjuhën shqipe, angleze, turke, serbe. Pra, të kemi të drejtë si komunitet boshnjak të vlerësohet kjo e drejtë, sipas kërkesës.

Kryetari i Komisionit, në bazë të praktikës, tri gjuhët zyrtare të përdorura, janë në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze. Por çështjen që e ngriti z.Bajrami, mbase është çështje e nivelit më të lartë politik. Kërkesa është mirë që të sillet me shkrim dhe të shqyrtohet në Komision. Materialet që procedohen, kryesisht vijnë.

Rexhep Selimi, lidhur me kërkesën e z. Bajrami, tha se propozimi është mirë të sillet me shkrim dhe ky propozim të jetë i bazuar në Ligjin për gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës.

6. Të ndryshme

Kryetari i Komisionit, theksoi se pas raportimit në Komision të ministrit të Punëve të Brendshme dhe drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, në kuadër të Komisionit, ka kërkesa që të realizohet një takim i përbashkët në mes të Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së dhe Komisionit për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë. Për të qenë më korrekt, propozoi që kërkesat e propozuara në Komision, t'i hedhim në votim.

Rexhep Selimi, theksoi se një takim i tillë është i mirëpritur dhe produktiv. Gjithashtu, propozoi që të realizohet një takim i ngjashëm, në përputhje me mandatin që ka Komisioni, me kryeministrin e Republikës së Kosovës, sa i përket temave që janë trajtuar në Komision. Nga raportimi i fundit i ministrit të Punëve të Brendshme dhe drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës, nuk kemi marrë përgjigje për disa nga pyetje të bëra dhe këto përgjigje i janë adresuar diskrecionit të kryeministrit, prandaj një kërkesë e aprovuar nga ana e Komisionit, për një takim me kryeministrin, për çështje të caktuara që kanë të bëjnë me sigurinë, do të ishte i nevojshëm.

Nuredin Ibishi, lidhur me bashkëpunimin mes dy komisioneve, theksoi se ky bashkëpunim është i nevojshëm, ndërsa sa i përket aspektit të transparencës, pasi duke marrë shkas rastin e Kumanovës, tek ne është krijuar tradita jo e mirë që përveç zëdhënësve qeveritarë, nuk ka informacione dhe nga kjo krijon shqetësime tek qytetarët. Prandaj, përkrah kërkesën për të realizuar takime të përbashkëta. Ndërsa, sa i përket nëse përgjigjen autoritet apo jo, vlerësoi se si Komision, duhet të ushtrojë rolin që kemi, ndërsa pjesa tjetër u mbetet atyre.

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, me vota unanime, nxori këtë

PËRFUNDIM

T'i bëhet kërkesë kryetarit të Komisionit për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, për realizimin e një takimi të përbashkët të dy komisioneve, si dhe stafit drejtues të Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë.

Kryetari i Komisionit, gjithashtu, hedhim në votim kërkesën e z.Rexhep Selimi, që të ftohet në takim informues, kryeministri i Republikës së Kosovës.

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, me vota unanime, nxori këtë

PËRFUNDIM

T'i bëhet kërkesë për takim informues, kryeministrit të Republikë së Kosovës, lidhur me çështje të caktuara të sigurisë në Republikën e Kosovës.

Kryetari i Komisionit, në vazhdim, njoftoi anëtarët për takimin e realizuar me kryetarin e Komunës së Gjilanit dhe nga ana e tij është drejtuar kërkesë dhe mbështetje për t'ju ndarë një hapësirë nga kazerma e FSK-së, për t'u përdorur nga Universiteti i Gjilanit. Pasi konsideroi që kjo kërkesë është e arsyeshme, kërkoi përkrahjen e anëtarëve që t'i drejtohet me një shkresë Ministrisë së FSK-së, që të miratohet kërkesa e kryetarit të Komunës së Gjilanit.

Rexhep Selimi, lidhur me këtë kërkesë, tha se nuk e di nëse është linja e duhur për ta adresuar në Komision, pasi Komisioni mund të japë kontributin, por janë dy ministri të cilave do të mund t'ju drejtoheshin, Ministrisë së Pushtetit Lokal dhe Ministrisë së Planifikimit Hapësinor. Mbështet ndihmën e Komisionit në këtë fushë.

Nuredin Ibishi, theksoi se parimisht e mbështet këtë kërkesë nga ana e Komunës së Gjilanit, por fillimisht të dihet nëse kërkesa është në procedurë gjyqësore apo administrative dhe më pas të procedohet, por theksoi se mbështet aspektin lehtësues nga ana e Komisionit për këtë çështje.

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, me vota unanime, nxori këtë

PËRFUNDIM

Komisioni i rekomandon Ministrisë së FSK-së, që të rishikohet mundësia që Ministria e FSK-së, të japë në shfrytëzim një pjesë të hapësirës së FSK-së në Gjilan për nevojat e Universitetit "Kadri Zeka" në Gjilan.

Qerim Bajrami, theksoi se nga takimi i fundit që Komisioni ka pasur me komandantin e FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Ramën, i është premtuar që do ta dërgojë një zyrtar nga FSK-ja lidhur me pyetjen e bërë nga ana e tij në këtë takim, që i është referuar përqindjes së komunitetit

boshnjak, në kuadër të FSK-së. Për këtë qëllim, kërkoi që nga ana e kryetarit ose administratës, të bëhet një rikujtim dhe të kemi informacion për këtë çështje.

Bojan Mitiq, bëri vërejtje për vonesën në pranimin e materialeve që shqyrtohen në Komision, pasi duhet përgatitja paraprake, para se të jemi në mbledhje të Komisionit. Për këtë qëllim, kërkoi që materiali të procedohet në kohë dhe të jetë i përgatitur për takim.

Kryetari i Komisionit, lidhur me vërejtjen e z.Mitiq, tha se nuk do të ketë vonesa në procedimin e materialeve dhe se për takimin paraprak, ka qenë çështje teknike dhe për këtë ka pasur vonesë. Me këtë pikë të rendit të ditës, e konsideroi mbledhjen e mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 12:45.

Përgatitur nga:
Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Daut Haradinaj